

**VENDIM**  
**Nr.194, datë 19.2.2009**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME  
KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “CEMERICA 1, 2, 3”, DHE MIRATIMIN E  
BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET  
SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurës ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim, transferim), të hidrocentraleve “Cemerica 1, 2 e 3”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Dhënie e bonusit prej 3 për qind të pikëve shoqërisë “REJ”, sh.p.k., për rezultatin teknik e financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), për dhënie me koncesion të këtyre hidrocentraleve.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese përzgjedhëse, për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Cemerica 1, 2 e 3”, të kërkojë shprehje të interesit dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**